



Rrjeti i Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë

Ftesë për media

04 korrik 2023

Rrjeti i Grave të Kosovës organizon ekspozitën “Dhuna nuk fshehet mrena mureve”

Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) **nesër**, më 05 korrik nga ora **10:00-16:00** te **Sheshi “Adem Jashari” në Vushtrri** organizon hapjen e ekspozitës “Dhuna nuk fshehet mrena mureve”.

Kjo ekspozitë ka për qëllim të ngrisë vetëdijen e qytetarëve të Republikës së Kosovës në lidhje me dhunën në familje dhe për t’i njoftuar ata për së afërmi me përgjegjësitë që institucione të ndryshme qeveritare dhe jo-qeveritare kanë ndaj tyre, për **mbrojtje nga dhuna në familje**.

Dhuna në shumë familje kosovare është përditshmëri tejet e hidhur. Mjerisht, në shoqërinë tonë personat që përjetojnë dhunë në familje akoma fshehen brenda mureve të shtëpisë. Kur njerëzit dëgjojnë dhunën te fqinjët, thonë “Çka bojnë ata mrena shpisë tyne, osht’ punë për ta”. Vetëm gjatë vitit 2022 kemi pasur 2764 raste të dhunës ndaj grave të raportuara në policinë e Kosovës. Gjithashtu që nga viti 2010 deri në vitin 2022 janë 50 gra të vrara nga burrat. Prandaj, është tejet e rëndësishme që kjo ekspozitë të organizohet dhe të njoftohen qytetarët për përgjegjësitë që institucionet kanë ndaj tyre.

Ftohen mediat ta përcjellin këtë ngjarje.

Kjo ekspozitë përkrahët nga Agjencioni Austriak për Zhvillim (ADA).